



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e jashtëzakonshme/urgjente e KKSB-së , e mbajtur më 22 Janar 2024.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 13:10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e KKSB-së: z.Nijazi Jashari, Komandant i Stacionit të Policisë; z.Shefki Selmani, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z.z.Xhafer Ademi, kryesues i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues i komunitit rom; znj.Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Nazif Sheqa, kryetar i këshillit të prindërve të arsimit në Podujevë; znj.Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike–Kërpimëh; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim; z.Bahri Selimi, përfaqësues i Emergjencave Civile-Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe z.Shemsi Jashari, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame znj.Sevdiye Mustafa, përfaqësuese e komunitetit egjiptian dhe z.Enver Rama përfaqësues i komunitetit rom.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it, Eset Qerimi, përfaqësues i Bashkësisë Islame (në zëvendësim të përfaqësuesit të Këshillit të Bashkësisë Islame z. Mensur Hoti); z.Mentor Vërshefci, z.Besat Maloku dhe Behar Pireva- Policia e Kosovës; z.Naim Raçi, u.d. drejtor i Gjimnazit “Aleksandër Xhuvani” dhe z.Ragip Fetahu, anëtar Kuvendit të Komunës, si dhe një numër i madh i mediave.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, të respektuar anëtarë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, më lejoni të hapi mbledhjen e KKSB-së, një takim i cili është thirrur urgjent ose i jashtëzakonshëm, pas rastit tragjik të vrasjes së të riut Lulzim Fejzullahu. Para se të vazhdojmë me takimin ju ftoj që bashkërisht të bëjmë një minutë heshtje për Lulzimin.

Rendi i ditës

- Situata e Përgjithshme e Sigurisë në Komunën e Podujevës,

Isha i shtyrë që sot të thërras këtë takim urgjent me të vetmen pikë të rendit të ditës, me theks të veçantë pas ngjarjes së fundit që ka ndodhur me të riun Lulzim Fejzullahu. Sigurisht që rasti është prej rasteve të rënda që kanë ndodhur në Komunën tonë përkundër faktit që nga të dhënat të cilat në mënyrë permanente i kemi marr nga Stacioni Policor i Podujevës gjendja e sigurisë deri tash ka qenë e qet dhe stabile, po thuajse në të gjithë

sektorët me përjashtim të sigurisë në komunikacion ku për kundër punës dhe angazhimit të zyrtarëve policor prapë se prapë kemi një numër të madh të aksidenteve të cilat janë duke ndodhur në rrugët tona. Rasti i fundit i vrasjes së të riut Lulzim Fejzullahut vërtet na ka prekur të gjithëve, ishte një rast i rënd, i ndodhur para disa ditësh, me të cilin sigurisht që organet kompetente të sigurisë janë marr me punët e tyre që lidhet me rastin, por nga ajo që doli fatkeqësisht ky rast u përmyll në mënyrën më tragjike për të riun Lulzim Fejzullahu. Të gjitha këto që sot dhe të ardhmen do i diskutojmë do të jenë në kuptimin e mbështetjes dhe mundësisë së marrjes së masave preventive me qëllim të zvogëlimit dhe parandalimit, që rastet e tilla të mos ndodhin më në Komunën tonë. Sigurisht që ne si institucione lokale me Stacionin policor në Podujevë kemi një bashkëpunim të ngushtë që rastet e tilla ti eliminojmë dhe të marrim veprime preventive që rastet e tilla mos të ndodhin në shkollat tona. Në vazhden e kësaj pune dhe këtij angazhimi të përbashkët sigurisht janë edhe punët rutinore të cilët zyrtaret policor i bëjnë në veçanti në tri shkollat e mesme të larta por edhe në shkolla tjera të qytetit të Podujevës dhe në rrethinë dhe krejt kjo me qëllim që të parandalohen dukurit e ndryshime negative që mund të ndodhin, mirëpo fatkeqësisht rasti i vrasjes së Lulzimit Fejzullahut dhe përfshirja në këtë rast edhe të njërit prej nxënësve të Gjimnazit “Aleksandër Xhuvani” që ishte nxënës i kësaj shkolle me të vërtet na bëri që të shqetësohemi. Qëllimi i këtij takimi është të shohim mundësitë dhe të bisedojmë bashkërisht me anëtarët e KKSB-së, në radhë të parë për të marr informacionet më të detajuara rreth ecurisë dhe trajtimit të krejt kësaj problematike që ka ndodhur dhe sigurisht të shohim hapat që do t’i ndërmarim bashkërisht me të gjitha këto institucione, në mënyrë që rastet dhe situata të tilla mos të ndodhin. Ne e dimë që Komuna e Podujevës është prej komunave të mëdha dhe përkundër krejt këtij fakti ndoshta kemi qenë prej komunave më të qeta në kuptimin e sigurisë, ka pasur incidente të lokalizuara të cilat vërtet janë trajtuar qoftë nga autoritetet lokale që është varur prej tyre qoftë prej organeve të sigurisë që i kryejnë punët dhe detyrat në komunën tonë dhe deri tash kemi arritur që bashkërisht ti menaxhojmë këto probleme, mirëpo rasti i fundit ishte një rast tragjik i cili na ka prekur të gjithëve dhe nga ky takim që jemi së bashku këtu po shfrytëzoj nga rasti që familjes të ndjerit ti shprehi ngushëllimet më të sinqerta dhe shpresojmë që këtë humbje të madhe të birit të tyre familjarët ta tejkalojnë sa ma lehtë që është e mundshme, përkundër që e kemi dhimbje me këtë familje sepse me të vërtet humbja e një të riut në këto rrethana që fatkeqësisht e kemi parë të gjithë ishte një ndjenjë e dhimbshme e të gjithë neve dhe ky rast duhet të na vetëdijesojë që veprimet dhe punët tona në të ardhmen t’i marrim në një shkallë më të lart të seriozitetit në mënyrë që situatat e tilla mos të ndodhin. E theksova edhe më herët, kemi marr një varg punësh dhe veprime të përbashkëta me stacionin policor në Podujevë duke siguruar zyrtar policor në rroba civile për të përcjellë gjendjen në shkollat dhe në veçanti në tri shkollat e mesme të komunës sonë por edhe në shkollat tjera dhe sigurisht që në vazhden e këtij angazhimi të përbashkët deri tash kemi arrit ti realizojmë një varg punësh qoftë përmes programeve të ndryshme të ndërgjegjësimit që lidhen me përdorimin e lëndëve narkotike, kontrolle të ndryshme sistematike të cilat janë zhvilluar kohë pas kohe nëpër objekte të ndryshme shkollore dhe sigurisht edhe në objekte tjera përcjellëse për brenda komunës të cilat faktikisht krejt këto janë bërë me qëllim të parandalimit të dukurive të tilla, mirëpo rasti i fundit edhe për kundër krejt këtij angazhimi ndodhi dhe besoj është një momentum që ne duhet të ulemi bashkërisht dhe të shikojmë se cilat do të jenë veprimet e mëtutjeshme të cilat duhet të ndërmerren dhe në cilat drejtime duhet të orientojmë punën dhe angazhimin tonë të përbashkët në mënyrë që dukurit tjera të mos ndodhin jo vetëm në komunën tonë por askund tjetër. Duke pasur parasysh që situata është e ndjeshme kërkoj nga mediat që

të na lirojnë sallën, tani e tutje po fillojmë diskutimin brenda për brenda këtij takimi në mënyrë që të kemi informacione më të sakta prej organeve të sigurisë. Pasi të përmbyllim këtë takim do të jem i gatshëm të prononcohem për media në cilësinë e Kryetarit të Komunës por këtë mund ta bëjnë edhe të tjerët nëse lejojnë kushtet dhe rrethanat për tu prononcuar.

Konstatim:

Pas thirrjes së Kryetarit të gjitha mediat liruan sallën e Kuvendit, për të krijuar hapësirë për punë të Këshillit.

Të nderuar anëtarë të KKSB sikurse e theksova më herët, e përsërisë se rasti si rast që ka ndodhur para pak ditësh në Komunën tonë na ka prekur të gjithëve, është humbje e madhe për arsyeje se e kemi humbur një të ri në moshën e re, një i ri i cili prej asaj që del në opinion ka humbur jetën për arsyeje krejt banale dhe na ka tronditur të gjithëve. Unë, çdo javë përkatësisht në periudhë dy javore marr një raport të gjendjes së sigurisë brenda komunës sonë dhe një raport të tillë e kam marr para pak ditësh pra me 15.01.2024 i cili raport në pikën dhjetë e përshkruan një rast i cili ka ndodhur në komunën tonë dhe në këtë raport shkruhet që jemi të informuar për një rrahje që ka ndodhur, ku njësitë policore kanë dal në vend të ngjarjes, kanë trajtuar rastin dhe viktimën në këtë rast i lënduari është dërguar në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Podujevë dhe nga këtu në gjendje të rëndë është përcjell në QKUK në Prishtinë. Në vend ngjarje janë gjetur dhe sekuestruar një thikë dhe një veturë, lidhur me rastin janë identifikuar dy persona të dyshuar, që të dy të mitur, në prani të punëtorit të qendrës për punë sociale dhe avokatit të caktuar sipas detyrës zyrtare janë intervistuar dhe pas konsultave me prokurorin kujdestar për të mitur të dyshuarit janë dërguar në qendrën e ndalimit për 48 orë. Kjo ishte e tëra nga informata dhe të tjera informata nuk kam për rastin. Kërkoj nga Komandanti i Stacionit Policor na jap informacione shtesë ato të dhëna që janë publike sepse tash si rast sigurisht që i ka specifikat e veta dhe e dyta kam kërkuar që sot në këtë takim të jenë edhe zyrtarët policor të cilët e kryejnë shërbimin e tyre në shkollat e mesme të larta në Komunën e Podujevës, si zyrtar policor me veshje civile. Aktualisht kam një varg informatash prej burimeve të ndryshme por jo informata se qysh duhet të jenë. Në këtë takim e kam ftuar edhe drejtorin e gjimnazit “Aleksandër Xhuvani” të cilin e falënderoj që ka shpreh gatishmëri që të jetë sot këtu edhe pse nuk është pjesë e KKSB, me të vetmen arsye pasi që njëri prej të dyshuarave është nxënës i kësaj shkolle. Unë përmes drejtorisë komunale për arsim por edhe drejtpërdrejtë sot me drejtorin kam bërë përpjeke të marr informacione shtesë dhe nga informacionet që po marr prej shkollave tona i dyshuari kryesor që duket në video nuk është nxënës shkolle që nënkupton se ai ka kaluar moshën 18 vjeçare dhe nuk llogaritet i mitur dhe besoj që policia këtë çështje e din më së miri dhe të na informoj për këtë proces. Nga informatat që i kemi marr nga burimet tona por në veçanti nga informatat që i kemi marr nga drejtoria komunale e arsimit dhe përmes shkollës del që nxënësi Artiol Abdullahu është nxënës i klasës së 11, është një nxënës i dobët, me afër 8 nota të dobëta dhe këtij nxënësi iu është thyer nota e sjelljes nga 3 në 1 që nënkupton që notën e sjellës veç e ka pas më herët të thyer pra nuk ka qenë prej nxënësve të qetë, me 31 mungesa të paarsyeshme, këto janë informatat që i kemi nga drejtoria e shkollës. Unë besoj që zyrtarët policor të cilët kanë punuar atje në këto shkolla mund të na japin edhe informata shtesë, ka informata jo zyrtare edhe pse nuk është mirë të bisedohet kjo, mirëpo jemi në këtë këshill bashkërisht këtu, që para pak kohe i njëjti nxënës është legjitimuar nga këta zyrtar policor dhe nëse është e vërtet këta mund të na tregojnë më vonë këtë fakt, por e përsëris janë burime jo zyrtare dhe nëse ne kemi mundur që ti kemi këto informata nganjëherë shtrohet pyetja cilat veprime i kemi

marr si institucione që të kemi situatën në kontroll. Krimet kudo në botë ndodhin dhe është vështirë të ndalen por nëse kemi pasur ndonjë sinjal që procesi nuk është duke ecur mirë ndoshta është dashtë të marren veprime shtesë dhe nuk jam në dijeni se a i kemi marr. Ai i ri më nuk është në rrethin tonë, një familje me gjendje ekonomike të rëndë sipas informacioneve që kemi marr, fëmijë jetim të rritur në kushte shumë të rënda ekonomike por relativisht të edukuar të cilët kanë bërë përpjekje që me punë të ndershme të sigurojnë kafshatën e bukës. Në krejt këtë proces ndodhi ajo që është më e keqja, që deshëm apo nuk deshëm e ndiejmë vetën përgjegjës për atë që ka ndodhur. Kemi bërë përpjekje për të marr masa preventive dhe prezenca e këtyre zyrtarëve policor civil në shkolla është e vetmja arsyeje që ti ndalojmë situatat e tilla. Por nuk është vetëm detyre e zyrtarëve policor, është detyrë e Drejtorisë së Arsimit, detyrë e Drejtorisë së shkollës dhe çdo njërit prej mësimitdhënësve për dhenë kontributin e tyre për të krijuar një klimë të qet dhe të sigurt në objektet tona shkollore. Përveç kësaj është edhe detyrë e këshillit të prindërve për të punuar më tepër me prind që të parandalohen dukurit e tilla. Ne këtu shpesh herë në takimet tona me komandantin e stacionit policor kemi diskutuar gjerë e gjatë për masat dhe veprimet që duhet të ndërmerren jo vetëm në shkolla po edhe në qytetin e Podujevës që qytetarët tanë të ndihen më të sigurt dhe që të gjejnë rrugë dhe mënyrë më të lehtë se si ti parandalojmë dukuritë negative të cilat fatkeqësisht po na ndodhin në shoqërinë tonë jo vetëm në Podujevë por gjithandej Kosovës. Rasti i fundit është rast jashtëzakonisht i rëndë dhe na ka prekur të gjithëve dhe si i till normal e ka dëmtuar jashtëzakonisht shumë familjen, ka dëmtuar reputacionin tonë si komunë dhe të gjithave organeve pa marr parasysh të sigurisë apo organet tjera të nivelit lokal. Ne kemi problem shumë me trafikun e qytetit, të cilin fatkeqësisht nuk po mundemi me rregullua por së paku raste si ky i fundit të rëndë nuk kemi pasur deri tash. Nuk jam në dijeni se në vargun e këtij zinxhiri të komunikimit të punës, a ka pasur lëshime a po jo dhe është mirë që ato që janë për publikun t'i diskutojmë së bashku sot dhe kjo me të vetmin qëllim që raste të tilla mos të na ndodhin në Komunën tonë. Unë deri tash shumë herë jam mburrur që jemi Komunë e qet, natyrisht që ka dukuri devijante por që deri tash mendoj se janë menaxhuar relativisht mirë, mirëpo ky rast na qiti në shesh që kemi zbrastësi ende. Nëse kemi situata të tilla që në mënyrë permanente një person i caktuar ka vepra të njëpasnjëshme atëherë nga organet e drejtësisë ku gjendet gjenden forma dhe mënyra që të tejkalohen këto, e që po anashkalohen, kjo është diçka që duhet të na brengos. Nëse një individ që mund të jetë i përfshirë në këtë rast ka pasur edhe një varg veprimesh tjera paraprahe dhe i cili në forma të ndryshme ka mundur ti kaloj deri në këtë situatë, dua të theksoj se unë nuk jam në dijeni për këto gjëra dhe kisha pritur që disa prej informacioneve që janë për publikun të na jepen sot këtu, në mënyrë që edhe ne të informohemi dhe të bindemi të gjithë që ne kemi kryer punën mirë, rastet ndodhin krimi në botë askund nuk është ndalur dhe është fatkeqësi që ka ndodh për ne të shohim se ku jemi në raport me këto situata, në mënyrë që të gjitha këto të mënjanohen. Në radhë të parë i bëjmë apel familjarëve tanë që me fëmijët e tyre të punohet më shumë dhe të vetëdijesohen që të mos i bëjmë dëme askujt sepse bërja e dëmit ndaj tjetrit është dëm edhe ndaj vetit. Besoj që është momenti i fundit që edhe niveli lokal dhe niveli qendror si dhe organet e sigurisë të fillojnë një fushat vetëdijesimi për krejt këto dukuri negative që po ndodhin ë shoqërinë tonë. Rasti më i fundit që doli dje në mjetet e informimit si therje me thikë, nuk e di sa janë reale, kjo është një situatë që duhet të analizohet pak më thellë. E kam parasysh që si komunë gjatë kësaj periudhe kohore jemi duke i vuajtur pasojat e numrit të vogël të zyrtarëve policorë të angazhuar por e shohim që e kemi një varg mangësish të përditshme që ne mund ti shohim si qytetarë, prandaj unë pa dashtë sot që

askënd të atakojmë kisha kërkuar prej Komandantit të Stacionit policor dhe në veçanti prej zyrtarëve policor të kanë mbikëqyrë nivelin e sigurisë në institucionet shkollore të na japin ndonjë informacion që është i vlefshëm për ne por në këtë situatë edhe për publikun sepse rasti është në hetuesi dhe gjithmonë pa i cenuar rregullat e sekreteve që mund ose duhet të ruhen në këtë proces. Fjalën ia kalojmë Komandantit të Stacionit Policor. **z.Nijazi Jashari**, Theksoi, jemi mbledh këtu sot në këtë takim të jashtëzakonshëm dhe do të mundohem që të jem i shkurt sepse këtu i pranishëm është edhe shefi i sektorit të hetimeve i cili ka bukur shumë shënime dhe do të na njoftojë të gjithë neve me ecurinë . Të pranishëm janë edhe dy zyrtarët policor të cilët janë të angazhuar për situatën e sigurisë në shkolla dhe të cilët kanë shënime dhe informata rreth të dyshimëve. Kanë qarkulluar disa informacione që është fshehur diçka dhe në fillim nuk është ditë mirë, por vdekja e këtij të riut ku me të vërtetë na ka brengos tash i ka shfaq në sipërfaqe disa gjana. Ju siguroj të gjithë juve dhe opinionin publik që të gjitha veprimet e mundshme nevojshme policore janë marr rreth këtij rasti, janë arrestuar dy të dyshuar që gjenden në qendrën e paraburgimit, për një të dyshuar kemi më shumë fakte dhe nuk është hera e parë që është i përfshirë jo në vrasje por raste të tjera, nuk dua të shfaqësoj policin sepse më larg se te gjykata nuk kem ku të shkojmë. Aq sa unë kam informata, e që tash na njoftojnë edhe zyrtarët prezent e sidomos shefi i hetimeve, ai ka pasur edhe një rast tentim vrasje më herët dhe ka qenë i dënuar me kusht për tri vite. Se çfarë vendimi merr gjykata nganjëherë neve na brengos si zyrtar policor, por nuk dua të merrem me politikë sepse nuk e kam atë qëllim por këto gjëra duhet të rregullohen, policia e merr e dërgon ndërsa gjykata e liron me kusht dhe me sa e di unë ka qenë i dënuar, kjo nuk është hera e parë dhe ja rasti ndodhi, ka mbytur të riun dhe forma që ka përdorur për të kryer aktin është tepër e rëndë sepse mos të keqkuptohem se për polici ky është një rast dhe është një statistikë por mënyra dhe metoda se si është kryer është tepër e rëndë, në polici hyn si statistikë një vrasje e rëndë por nuk është zgjidhje kjo, nuk është vetëm çështje policore, sjelljet e këtyre të rinjve nuk është vetëm çështje policore, nuk është vetëm çështje e arsimit, nëse bashkërisht nuk punojmë e gjithë familja, rrethi dhe shoqëria por edhe xhamia, nëse nuk ndërmarrin të gjitha veprimet së bashku. Policia e arreston tjetri del e bën dhe unë nuk mund të garantoj që nuk do të ketë raste tjera. Rasti në fjalë është shumë i rëndë për arsyeje të mënyrës se si është kryhet, shumë brutale dhe e vrazhdë. Për të gjitha këto do të na informoj edhe shefi i hetimeve ku i ka të gjitha shënimet e sakta për deri sot se çka ka ndodhur edhe policët civil i kanë trajtuar dhe i kanë jep dënimet. Me sa kam informacione njëri ka qenë edhe i suspenduar nga shkolla dhe gjatë asaj kohe e ka kryer një vepër penale dhe nuk është hera e parë që policia ballafaqohet me të. Nëse më lejohet kisha ftuar shefin e hetimeve të na njoftoj në detaje dhe ecurinë e rastit. Po ju njoftoj që ne i kemi marr veprimet, patrulla ka dal në vend të ngjarjes dhe ka bërë raportin. Raportin që e pranon kryetari është në pika të shkurta, pra ka qenë raport deri sa ka parë policia dhe jo çka ka ndodh më tutje sepse ky rast menjëherë ka kaluar në kompetencë të hetimeve rajonale ku na bashkëpunojmë me të më pas ata i qojnë këto gjëra më tutje.

z.Mentor Vërshefci, Përshëndetje të gjithëve, dëshiroj që të jap disa informacione lidhur me rastin në pika të shkurta sa i takon procedurave. Stacioni Policor me të marr informatën menjëherë ju ka përgjigjë rastit me urgjencë duke e trajtuar brenda një periudhe shumë të shkurt ku brenda 2 minuta vetëm ka arrit në vend të ngjarjes dhe ka identifikuar se në rr. "Isuf Gërvalla" është gjetur një person i shtrirë pa ndjenja në tokë ku e ka verifikuar dhe e ka lajmëruar edhe emergjencën e cila ndal në vend të ngjarjes dhe i është dhënë ndihma e parë ku viktimën e ka marr dhe e ka dërguar këtu në

emergjencë të Podujevës ku pas kësaj e kanë konstatua që gjendja e tij është e rëndë dhe është transportuar në QKUK-së me përcjellje të policisë. Pas një kohe shumë të shkurt ka ardhur njëri prej të dyshuarve që ka qenë pjesëmarrës në atë ngjarje dhe ka pranuar tretman mjekësor në emergjencën e Podujevës me çrast është bërë sigurimi i tij, janë marrë informacione tjera shtesë se cilët të tjerë ka qenë tjerë të përfshirë në këtë ngjarje, është bërë sigurimi i vendit të ngjarjes ku janë njoftuar stacionet adekuate dhe prokurori i shtetit i krimeve të rënda, janë siguruar edhe disa dëshmi incizime dhe dëshmi materiale në vendin e ngjarjes të cilat i janë përcjell prokurorit në formë elektronike, janë njoftuar hetime regjionale për shkak se natyra e rastit ka qenë e rëndë dhe është kompetencë lëndore trajtimi i këtyre rasteve për hetimet regjionale, po ashtu ka qenë edhe në vend të ngjarjes edhe krim teknika regjionale ku ka bërë sekuestrimin e dëshmimeve në vend të ngjarjes dhe dëshmime tjera në lokacione të dyshuarve ku është sekuestruar vetura dhe pajisja tjetër që është përdorur për ta kryer veprën penale pra një shkop i bejsbollit, po ashtu në vendin e ngjarjes është gjetur një thikë dhe për momentin nuk e dimë se kujt i përket dhe në bazë të ekspertizës së ferozikës kjo do të vërtetohet. I dyshimti pas marrjes së tretmanit në shtëpinë e shëndetit në Podujevë është sjell në stacion, më pastaj u arrit të arrestohet edhe personi tjetër i dyshimtë dhe në prezencën e avokatëve mbrojtës, Qendrës për Punë Sociale dhe prindërve të tyre janë marrë prova dëshmuese të tyre lidhur me rastin ku hetimet rajonale i kanë përcjell në prokurori dhe të dyshimtëve u është caktuar masa e ndalimit për 24 orë, pastaj masa e paraburgimit. Njëri prej të dyshimtëve në bazë të shënimeve që posedon policia është i përfshirë në tetë raste ku në këto raste ka kryer 12 vepra penale, shumica e rasteve janë raste të natyrës së rëndë si lëndim i lehtë trupor, mbajtje dhe pronësi të armës pa leje, lëndim i rëndë trupor përsëri mbajtje e armës pa leje, dhe një rast ka ndodhur në oborrin e shkollës ku është kap në flagrancë nga policia e Kosovës të cilët punojnë në shkolla, po ashtu në raste të tjera në vrasje, tentim vrasje ku ka qenë i përfshirë së bashku me familjarët e tij. Sipas informatave që kemi në një rast lëndim i rëndë trupor është dënuar me kusht 3 vite gjysmë mirëpo brenda kësaj periudhe e ka kryer edhe veprën e rëndë vrasje e rëndë. Vepra fillimisht është kualifikuar nga prokurori përkatës vrasje në tentativë dhe pas vdekjes së të ndjerit vepra është ri kualifikuar si vrasje e rëndë. Rasti për momentin është duke u trajtuar ende nga hetimet rajonale në bazë të procedurave dhe kompetencave të tyre. Të dytë të dyshuarit janë të vitit 2006.

z. Shejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, faleminderit për informata kërkoj nga zyrtarët policor që kanë qenë në teren brenda kornizave që janë të lejueshme të na informojnë diçka më tepër.

z. Besart Maloku, zyrtar policor, theksoi, Eltion Kadriu ka qenë nxënës i shkollës Ekonomike dhe ka qenë nxënës problematik mirëpo fal punës tonë dhe angazhimit tonë gjithashtu edhe koordinimi i mirë me drejtorin e shkollës të asaj kohe, ne me datën 04.10.2021 është iniciuar rast ndaj Eltion Kadriut armë mbajtje pa leje, e kjo është edhe një dëshmi që ju ka gjetur thikt kur ka qenë nxënës i shkollës. Në koordinim me drejtorin e shkollës i cili në atë kohë ka qenë Fehmi Zeqiri përveç rastit që ju është hapur, ndaj të njëjtit është iniciuar edhe procedura e suspendimit nga shkolla data 05.10.2021 deri me datën 04.11.2021. Të gjitha punët dhe procedurat janë kryer më së miri por i njëjti deri sa ka qenë i suspenduar me datë 23.10.2021, jashtë oborrit të shkollës, e ka shfrytëzuar rastin edhe te parkingu në rrugën “ Bedri Bajrami” e ka ther me thikë një nxënës tjetër dhe është iniciuar prapë rasti si lëndim i rëndë trupor, dhe pas asaj kohe ka vazhduar në arrati edhe më nuk është pjesë e shkollës. Ne i kemi iniciuar dy raste ndaj ti pra ka qenë nxënës problematik ku ne gjithashtu edhe drejtori i shkollës si dhe drejtoria komunale e

arsimit i kemi marr të gjitha veprimet dhe punën e kemi kryer më së miri ndërsa sa i përket nxënësit të dytë të gjimnazit nuk ka raste, për sukses e dimë por nuk është i përfshirë në raste.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, Faleminderit Besart për këto informacione, nëse ndokush nga organet e sigurisë nuk ka ndonjë informacion shtesë që mund të na japin, atëherë e hapim diskutimin.

z.Nijazi Jashari, theksoi, shefi i hetimeve sa kam unë informacion ka shkuar edhe te shpija e ka kontrolluar edhe për raste të tjera janë në dijeni këta.

z.Mentor Vërshefci, theksoi, për të gjitha rastet të cilën kanë qenë personat e dyshimtë pra çdo herë është bërë kontroll me urdhër të prokurorit dhe gjykatës, janë bërë kontrollet në shtëpitë dhe lokacionet e personave të dyshuar. Për çdo sjellje devijante apo shkelje ligjore janë marr masa të menjëhershme, pra me rastin e kryerjes së veprës penale atë ditë brenda 20 minuta është arrestuar i dyshuari i parë dhe brenda një ore e gjysmë u arrestua edhe personi i dytë për veprën të cilën e kanë kryer.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, a është sekrete për të ditur se kush është prokuror i kësaj lënde.

z.Mentor Vërshefci, theksoi, nuk është sekret por në lidhje me raste caktohen prokurorët kujdestar, ata e trajtojnë rastin derisa janë kujdestar më pas caktohet një prokuror tjetër. Edhe në Siboc në atë rastin e rëndë personi ka qenë i arrestuar por është liruar në procedurë të rregullt. Ndërsa për rastin në fjalë sa ka qenë nxënës i suspenduar për atë rast është dënuar 3 vite e gjysmë dhe brenda kësaj periudhe i ka edhe disa raste të tjera.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, kjo po nënkupton që për disa vepra të lehta është dënuar ndërsa veprat e rënda si kanë marr për bazë. Faleminderit toger, nëse ndokush prej juve dëshiron të marr fjalën urdhëroni.

z.Shemsi Jashari, theksoi, normal që jemi ndje keq edhe jemi tronditur nga ky rast si gjithë qytetarët tjerë ndoshta për shkak të mënyrës se si është kryer kjo vepër penale, kjo vrasje. I shpreh ngushëllime familjes, miqve dhe gjithë atyre që e kanë njohur. Si KKSB në dy vitet e fundit kemi bërë pak për aspektin e sigurisë. Ajo që ka ndodh në këtë rast tragjik është e tmerrshme, për nga mënyra se si është kryer ajo vrasje dhe si pasojë shkakut ka lindur shumë më herët dhe është shpërthyer te ky rast. Është rasti i fundit që e mbajmë mend më mirë dhe na ka tronditur por nuk është larg në kohë që kemi një vrasje nga një i ri në mes të një marketi që ka rrezikuar shumë qytetarë dhe për nga mënyra se si është kryera ajo vrasje duket vrasje goxha profesioniste por nëse shohim në ato video për nga moshë kryerësi është i ri pra nuk është rasti i vetëm që ka ndodh. Tronditja ndoshta është më e madhe për faktin e mënyrës se si është zbatuar ajo vrasje. Ajo se çka po shohim në baza ditore edhe çka dimë në bazë të përvojës që kam në të kaluarën profesionale, kur involvohet policia është vonë mandati i policisë për të ndërhyrë vjen shumë vonë si akter në skenë, ajo çka po na mungon neve e që po e shohim është një degradim i vlerave të përgjithshme duke u nisur nga familja e institucionet që janë përgjegjëse për këtë punë. Një barrë të përgjegjësisë e kanë të gjithë akterët publik, në rendë të parë politika me këtë sistem arsimor, ku e kanë ngarkuar nxënësin me libra në shpinë e që peshojnë 15 kg dhe nuk kanë kurrfarë përmbajtje, në ato libra nuk folet asgjë me fokus për familjen, për moralin dhe sjelljen. Teori të thatë edhe biznes për shtëpinë botuese asgjë për të mësuar diçka duke shtuar edhe mënyrën e jetës dhe avancimin e teknologjisë edhe fokusin që të rinjtë edhe na si të rritur në moshë jemi të varur nga teknologjia. Mënyra e jetesës ka ndryshuar ndërsa mënyra e të menduarit të përgjegjësve kur bëjnë programet e arsimit kanë mbetur aty ku kanë qenë para 20 viteve apo 30. Nëse e shohim organizimin e brendshëm të shkollave trekëndëshi nxënës prindër

arsimtar dhe DKA është i shkëputur dhe nuk funksionon asnjë hallk e menaxhimit të brendshëm, nëse flasim për shkolla po flas edhe prej përvojës që kam qenë Kryetar i Këshillit Drejtues të një shkolle ku i kam pasur fëmijët në shkollë dhe nuk po flas se pse po më pëlqen dhe as me tendencë, por nuk funksionin këshillat e prindërve, zakonisht drejtorëve të shkollave po ju pëlqen të kenë nga një përfaqësues të prindërve që nuk i bënë shumë telash edhe i bëjnë do raporte formale. DKA në Podujevë zero aktivitet ka bërë në aspektin e sigurisë për shkolla, zero aktivitet për të bërë funksional këtë trekëndësh që do ti ishte njëra prej nismës ku ndoshta do të parandalojnë disa prej rasteve sikurse rasti ka ndodhur, normal që krimet kanë ndodhur dhe ndodhin edhe në vendet më të zhvilluara me sistemin arsimor dhe edukimin më të avancuar dhe thuhet që njerëzit janë të lindur kriminel edhe bëjnë vepra të tilla por ndoshta do të kishim mundur t'i parandalojmë shumë tjera. Po flasim për këtë vrasje por e kemi problemin me droga, e kemi problemi me dukuri asociale, problem me keqpërdorim dhe abuzim me rrjete sociale dhe platforma që përveç degjenerimit asgjë tjetër nuk shërbejnë për të rinjtë tanë, ku i kemi platformat mediale që na servojnë degradim e degjenerim në baza ditore 24 orë, i kemi institucionet që sa herë që nisë një iniciativë për tu bërë diçka e mirë dalin dhe përplasen si parti politike jo unë jo ti e në fund jemi në një situatë ku pa të keqe për të thënë, duhet të ju lutemi zotit që të mos ndodh diçka sepse në këtë sistem ndodh gjithçka. Ajo çka unë kisha dashur për të dëgjuar në këtë rast edhe pse të jemi të sinqertë i di raportet dhe problemin kryesor e kemi më shumë me arsimin fillor se sa me të mesëm, po dalin nxënës analfabet nga shkolla fillore. Për fat të keq nuk janë publike statistikat e që drejtori është në dijeni por besojë që edhe te Kryetari ka raportua sa është numri i nxënësve që nuk dinë shkrim lexim dhe kanë arritur në shkollë të mesme, një e keqe nëse fshihet shpërthen ndokund, fshihet për një kohë por nuk e di kujt mund t'i shërbej që të fshihet dhe asnjë masë nuk e kemi. Kemi ndërtuar shkolla të mira dhe mirë shumë që po ndërtohet objekte të tilla por nuk kemi ndërtuar në përmbajtje, arsimtarët tanë pa dashur të theksoj me emra në orët e mësimi i sheh në kafe dhe për fat të keq më shumë merren me politikë ata se sa ju që jeni të thirrur për atë punë. Në orët e mësimi fëmijëve ju japin disa detyra ose nuk ju japin hiç edhe dalin në kafe dhe flasin për politik gjë që është keq, mbikëqyrja nga Drejtoria dhe zyrtarëve përgjegjës nga DKA po mungon dhe nuk duhet të jesh shumë i mençur, mund të dalësh në orar të mësimi dhe ti shohësh kafet për rreth shkollave dhe i sheh. Do të thotë nëse jemi ardhur në atë situatë ku unë kam qenë prezent vjen nxënësi dhe i thotë arsimtarit dhe profesorit “Babë çka bane” flasim për një degradim, ku i fol në kafiteri në prezencë të publikut me zë të madh, me një liri si të ishte moshatar edhe krejt në rregull vazhdon muhabetin me të në orar të mësimi. Pra Drejtoria e Arsimi do duhej ketë të dhënat për nxënësit problematik dhe atë listë të nxënësve ta përcjellët te organet e sigurisë për të pas vëmendjen te ata. Jemi në dijeni që përderisa personi nuk bënë diçka nuk mund tii bësh ndonjë gjë si policë, por megjithatë nëse ke në fokus një grup ku mund të dalin problemë nga ta, rasti konkret i personit në fjalë 7-8 herë me vepra penale, është dashtë që të ketë mandat policia që të kontrolloj në rrugë atë njeri sepse ai ka treguar që nuk shkon thatë pa pasur ndonjë armë me veti edhe vendet ku i frekuenton dhe njerëzit me të cilët rrinë. Jemi në njohuri me shkurtesat në staf por kjo nuk është dashtë të jetë vetmja arsyeje që thjesht mu dorëzua. Këshilli i prindërve është formalisht, e kemi edhe përfaqësuesin këtu që është në nivel komunal, asnjëherë nuk janë bërë zgjedhjet si duhet për tu zgjedh brenda shkolle, shkojnë emrat sepse aty kam qenë në mbledhje, ai thotë bëhu ti, bëhu ti se jam nxënë dhe a e din pse, se kurrë nuk ia ka shpjegua qysh duhet edhe nuk është marr seriozisht edhe nuk e kanë parë vetën të rëndësishëm nëse e japin një propozim a po e bëjnë ndonjë aktivitet sepse gjithmonë

është një dorë tjetër që vendos se çka për të bërë edhe thjesht vetëm fol e dikur lodhesh dhe përfundon krejt, pra do të thotë që është dashtë ti jepet rol ku DKA ka mandat dhe fuqi autorizim dhe buxhet për të organizuar aktivitete, ku e bind prindërin in në këshill të prindërve që nëse propozon dikush i merr parasysh dhe janë të vlefshme propozimet dhe iniciativat e tyre. Në aspektin e sigurisë Komuna e Podujevës asnjë cent nuk e ka të ndarë në buxhet me fokus sigurinë, ku nga 30 milion asnjë nuk është ndarë dhe as Këshilli që ne po flasim nuk e ka asnjë cent buxhet. Ka dy vite që kemi planin pa asnjë aktivitet të realizuar, kanë qenë do tryeza me fokus sigurinë që ka pas për qëllim mbledhjen e akterëve dhe për të dal diçka prej tyre, për tu diskutuar këto problematika që të gjejmë zgjedhje. Është Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që hap thirrje për OJQ-të për aktivitete të caktuara dhe asnjëherë nuk ka cek projekte me fokus dhe përmbajtje sigurinë , pra për të financua projekte përmbajtjesore e jo vetëm projekte veç se janë OJQ, pra duhet financuar ndonjë OJQ që ka përvojë në fushë sigurisë, që ka provojë në atë punë , me qëllim të involvimit të akterëve për të nxjerrët një produkt. Krejt çka dua të them është që ne është dashtë të marrim shumë më seriozisht problemin e sigurisë, me qenë shumë ma pro aktiv, kjo është problematikë që nuk është vetëm te ne të jemi të singertë, platformat publike dhe elektronike ku të rinjtë kanë qasje dhe frymëzohen për dhunë nuk i menaxhon komuna, nuk ka çka të bëjë me atë pjesë, por ka mundësi ndoshta Drejtoria e Arsimit për të marrë vendim për të zbatuar vendimin e vet që të ndalohen telefonat në shkolla të paktën gjatë mësimit, ka mundësi që atë listë të nxënësve problematik për ta diskutua me akterë të caktuar, me zytarin policor për komunitet si dhe me psikolog, me qëllim që të zvogëlohet dëmi sepse të gjithën është e pamundur të eliminohet, ka mundësi për të disiplinuar mësime të mësimdhënësve që të mos bëjnë notime pa meritë, ka raste kur edhe mua më tregojnë prindërit që shkon e kërkon në orë të mësimit mësime të mësimdhënësve dhe nuk e gjen fare, thjesht u jep nxënësve ca detyra dhe del ose e provokon një diskutim me njërin prej nxënësve pak më të zhurmshëm dhe krejt ora ecë pa shpjeguar asgjë, pra janë probleme që do duhej trajtuar më mirë. Shpesh herë e kemi dëgjua atë që mësime të mësimdhënësve ka kontratë të përhershme dhe nuk kemi çka t'i bëjmë, në pension nuk mundet sepse nuk e ka moshën, është shumë e paarsyeshme, një kontratë pune në moment që shkelet apo nuk përmbushet është argument i mjaftueshëm që të largohet ndokush nga puna qoftë edhe arsimtar. Të ishte një zyrtar i administratës dhe po të jepte një letër gabim i nxjerr punë një individ por e rregullon tjetër, një arsimtar e lenë një gjeneratë, po e devijon, dhe po bëhet si ajo ku na sot përballemi duke shtuar këtu edhe ikjen e qytetarëve për shkak të liberalizimit dhe shumë arsyeve të tjera, ku pasiguria si kjo mundet që të shtohet trendi edhe i ikjes, sepse njerëzit e kanë problem të planifikojnë të ardhmen në këtë ambient. E kemi vullnetin dhe gatishmërinë për çka do dhe çka mundemi për të bërë në kuptimin për ngritjen e ekipit punues të ekspertëve që i studion rrethanat e Podujevës dhe të shohim një qasje se çka mundemi për të bërë nëse nuk është vullneti i vendimmarrësve dhe i ekzekutivit që kanë mandatin për të punuar dhe për të bërë diçka.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, unë mund të pajtohem me disa prej atyre çfarë theksoi parafolësi, që është e vërteta nuk qëndron fakti që ne nuk kemi nda buxhet sa i përket çështjes së sigurisë për arsye se janë një varg projektsh të cilat janë realizuar dhe janë duke u realizuar në veçanti në qytetin e Podujevës por edhe në pjesët tjera të cilat i kemi llogaritur që janë problematike në mënyrë që të krijojmë qasje organeve të sigurisë që t'i kenë parasysh të gjitha veprimet që mund të pasojnë në ato hapësira. Kemi vendosur kamera në gjithë qytetin, pra në të gjitha pikat e rëndësishme të qytetit që të mundemi ti parandalojmë këto dukuri, në shkolla në mënyrë që të parandalohen dukurit negative sa është e mundshme. Arsyeja pse nuk është shkëputur

kontrata nuk qëndron sepse në momentin që vlerësohen ato gjëra besojë që pasojnë sanksionet, e që kemi shkëputje në mes këshillit të shkollave dhe shkëputje në mes mësimeve ato po shihen që janë evidente. Ju i treguat disa raste dhe nuk jam në dijeni nëse ndonjë prej tyre a është denoncuar në organet përgjegjëse, pra është mirë për t'u denoncuar sepse janë pjesë e kësaj shoqërie dhe jemi para se gjithash prind dhe i kemi fëmijët tanë. Unë besoj që edhe kjo hallkë e bashkëpunimit është duke na munguar, më e lehta është të japin komente dhe vlerësime por është mirë për tu bërë pjesë e atyre proceseve për të ndikuar pozitivisht sepse çdo njëri prej neve nëse e japim një kontribut sa do të vogël në këtë aspekt besoj që në fund do të kishte një rezultat shumë të madh. Nëse jemi të thirrur për të thënë ose për të parë të keqën por për të mos pasur tendencë për të vepruar, për të ndaluar atë, prapë është keq, çdo njëri prej cili do pozicion. A kemi probleme me menaxhim të shkollave nuk është që jemi të kënaqur, ka telashe dhe a mund të ketë arsimtar të tillë të papërgjegjshëm nuk dëshiroj të mohoj se mund të ketë, a mungon bashkëpunimi prindër me shkolla kjo po shihet tashmë. Sistemi është ky që është nuk është vetëm në Podujevë por në të gjithë Kosovën, është sistemi arsimor në gjendje të keqe, janë bërë një varg reformash që nga viti 2000 dhe asnjëherë nuk janë ndaluar reformat dhe asnjëra prej tyre nuk na është përshtatur fatkeqësisht, por nga vet fakti sipas informatave po rezulton që ndaj disa prej këtyre problemeve janë shfaqur në shkolla ka pas veprime mund ti quajmë të vogla apo të mëdha, por një veprim e ka kushtëzuar që njëri mos të jetë në shkollë pra kjo nënkupton që dikush është marr me këto situata, a mund të ndalohen këto veprime sigurisht që nuk mund të ndalohen është problem që të ndalohen dhe po të ishte një koordinim më i mirë i krejt këtyre hallkave ndoshta do të minimizohen këto probleme, unë besoj që këtë jemi duke e bërë. Sa i përket çështjes së buxhetit të Drejtorisë së Kulturës, ju e dini që financimi bëhet përmes thirrjeve publike, ku personat konkurrojnë me projekte të caktuara, mirëpo ne nuk mund ti detyrojmë personat që të konkurrojnë në projekte të sigurisë, realisht nuk kemi pasur asnjë prej projekteve së paku prej asaj që kam parë në listë që kanë qenë konkurrentë, nuk kanë konkuruar me projekte publike, gjë që është mirë në të ardhmen ti analizojmë këto që të mundemi të inkuadrojmë një pasues të veçantë për këto ose për të dhëne ndonjë poen pak më të lart nëse dikush vije me projekte të tilla sepse siguria në shkolla besojë që është e rëndësishme për çdo njërin prej neve dhe fundja nuk është vetëm detyrë e organeve të sigurisë sepse vetëm këta nuk mund t'i kryejnë këto punë dhe telashe. A ka vend për mbikëqyrje më të mirë besoj që ka dhe sa është duke u mbikëqyrtur është këtu edhe drejtori i arsimit, ndoshta unë mund të mos i kem të gjitha informatat por me vet faktin që është si drejtori ky duhet ti përcjell ato gjëra. Sot mund të potencojmë një varg problemesh të cilat po na përcjellin vazhdimisht dhe besoj shumë që një shkëputje në këtë hallkë zinxhiri të funksionimit të institucioneve ka prodhuar një situatë të tillë. Një familje e cila nuk e kontrollon si duhet fëmijën e vet, ka prodhuar një fëmijë të tillë, ku fatkeqësisht e shohim që nuk janë familje të varfëruara pra nuk janë familje që kanë mungesa financiare. Kemi shumë mangësi në këtë proces, jemi duke e parë, a duhet dhe a jemi duke bërë mjaftueshëm edhe kjo më duket po shihet dhe është mirë që në të ardhmen të punohet më tepër në të gjitha hallkat e këtij sistemi, me një bashkëpunim më të mirë mes veti në mënyrë që të mënjanohej dukurit e tilla, sepse tash i kemi dy raste sipas informacioneve, njëri që nuk ka të hapur asnjë rast që unë prapë nuk e di dhe mund të mos jenë dijeni as ata, ndoshta shkolla mund ta dijë më mirë edhe kemi rastin tjetër që është recidivist në vepra, që po të ishin marr me kohë veprime ndaj këtij recidivisti me siguri që ky rast nuk do kishte ndodhur, mirëpo jemi këtu ku jemi dhe është mirë të angazhohemi të gjithë që të mund të dalim nga kjo situatë. Pushteti lokal nivelin e

drejtësisë nuk e kontrollon dhe as sigurisë, pushteti lokal është një shtyllë ndihmese që rrinë afër tyre dhe ka raste që jemi duke i lodhur me kërkesa që në kushte normale nuk do duhej të rrjedhin prej neve ato kërkesa, sepse do duhej të ec vet procesi dhe të gjitha këto janë duke u bërë që të koordinohen punët më mirë mes veti, që të nxjerrim diçka të mirë që është në interes të sigurisë së përgjithshme. Kontaktet me Policinë i kemi në baza ditore por ju po e shihni që nuk mjafton që një apo dy institucione ta kryejnë punën si duhet kur i fundit që ka fjalën e dështon procesin për një arsyeje apo arsyeje tjetër. Në rastin e ndodhur para pak ditëve në Prishtinë e mbyti njërin në zebra, një profesor të respektuar dhe kam informacionin që njeriu që e ka shkaktuar këtë nuk është marr fare në pyetje ose është marr formalisht dhe ka ecur në shtëpi, pak a shumë jeni në dini për rastin. Por fatkeqësi e madhe është që na e humbëm një të ri të komunës sonë, një djalë që është munduar të siguroj kafshatën e bukës me punë prej ma të ndryshmeve të sinqerta, që sot më nuk është në mesin tonë e tash se ku është shkëputur hallka po thuajse të gjithë jemi duke e parë. Pse bëhet gjithë ajo zhurmë në baza ditore, javore e mujore nga niveli qendror që nuk është duke funksionuar kjo hallk janë me dhjetëra e qindra komente e informata që nuk po funksion hallka por ka të tjerë që po e mbrojnë këtë hallkë fatkeqësisht, pra kemi shumë të tillë që po e mbrojnë këtë hallkë që po theksojnë se është mirë dhe le të vazhdojë. Ne po mundohem ta bëjmë më të mirën e mundshme dhe nuk e di sa po ja dalim por nuk kemi asnjë lloj neglizhence që ti qojmë këto procese përpara.

z.Eset Qerimi, theskoi, KBI në Podujevë me shqetësim të madh mori dhe indinjate të thellë lajmin për vdekjen makabër që ndodhi në Podujevë, sigurisht që familjes i kemi shpreh dhe i shprehim ngushëllime më të përzemërta ndërsa kemi besim në institucione të sigurisë se do të bëjnë më të mirën e mundshme për të vendosur drejtësi. Ky rast edhe rastet tjera na japin indikacione që gjendja te rinia jonë nuk është në nivelin e duhur dhe besoj që është konstatim i të gjithëve, andaj mendoj që duhet një mobilizim mes gjithë akterëve relevant duke krijuar një strategji të mirëfilltë dhe duke vepruar drejt vetëdijesimit të rinis sonë për mirëkuptim tolerancë dhe dashuri vëllazërore. Ne si bashkësi islame duke e ditur besoj të gjithë edhe ju respektin që e gëzojmë në popull jemi të gatshëm të marrim pjesë aktive në kampanja të ndryshme për vetëdijesim në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përgjegjëse. Të gjithë jemi vëllezër shqiptar dhe nuk kemi djem dhe vajza për të humbur dhe për të përcjell në amshim në lule të rinis, më mirë një preventivë sot se sa një kurim nesër. Shpresojmë dhe lusim zotin se ky rast të jetë i fundit dhe nuk do të ndodhin raste të tjera të ngjashme. Ne me Komunën-Drejtorinë e Arsimit dhe Policinë e Kosovës kemi pasur një kampanjë para disa viteve kundër narkotikëve që është pritur shumë mirë dhe e theksoj me përgjegjësi të plot duke i përcjell edhe përshëndetjet e kryetarit që për shkaqe të ndryshmeve nuk ka mundur të jetë sot prezent, por shprehim gatishtërinë tonë të plot të jemi gjithmonë në koordinim aty ku e shihni të arsyeshme ne do jemi me juve, me popullin, për popullin.

z.Qefser Behrami, theskoi, kërkoj falje ndoshta jam duke folur me emocione sepse nga momenti që kam dëgjuar për rastin që ka ndodhur pak ndoshta edhe vajza ime e cila punon ne shkollën teknike kur më ka treguar për rastin duke qajtur për atë djalë i cili ka qenë një djalë i urtë shembullor që e ka mbajtur një familje për mendimin tim ai rast është kriminal sepse dihet mirë ku e tregon video një tendencë për të shkatërruar një lule të cilin e ka krijuar natyra. Prandaj na jemi mbledhur për këtë çështje dhe njeherit familjes miqve dhe të gjithë që e kanë njohur të ndjerin i shprehi ngushëllime. Unë jam i kënaqur me të gjitha diskutimet, ndërsa me fjalët e parafolësit tim më herët pjesërisht pajtoj. Nuk fajësohen të gjitha organet dhe objektivat që folët sepse nuk është krejt ashtu.

Pavarësisht, në momentin se jeni në dijeni se kush është x personi, shembull duhet folur me emër e jo të thuhet ai ose ai tjetri dhe nuk mundem me besua që ka raste të tilla. Unë vij nga shkolla e fshatit Kërpimehit dhe është shkollë që funksionon me të gjitha organet që ka shkolla, si Këshilli i shkollës, Këshilli i nxënësve dhe i prindërve që komunikojmë bisedojmë dhe mbajmë takime të tilla. Por ku është problematika këtu, problematika është që më ka ndodhur dy herë që në shkollë gjë të cilën nuk e kam cekur asnjëherë, një rast jashtë objektit të shkollës dy nxënës kanë pasur një konflikt ku me një brisk të vogël e ka ther në dorë tjetrin dhe për këtë janë në dijeni edhe organet. Ndaj tyre si shkollë kemi ndërmarrë masa i kemi transferuar në një shkollë tjetër për një muaj, pra këto i kemi bërë me organet e shkollës që janë, nganjëherë nuk duhet njeriu ti mbyll sytë e të sheh vetëm zi por duhet të shihet edhe bardhë. Pra nuk është që nuk është bërë punë por çka është më problematike që unë mendojë ndoshta është fajtor edhe sistemi i arsimit dhe organet më të larta sepse një nxënës i pa edukuar shkon dhe e lajmëron policin vetëm nëse arsimtari e ja ngreh pak veshin ose diçka të ngjashme dhe policia vijnë dhe i gjuhen arsimtarit pra këto janë ato telashet dhe kështu po vijnë problemet sepse nuk ka shkolla kompetencë që të merr vendime si në të kaluarën pra do të thotë që është një sistem i mbrapsht, pastaj sa herë që kam ftuar policin që janë në mbikëqyrje të shkollave asnjëherë nuk janë vonuar më shumë se 15 minuta dhe kanë ardhur në vendin e ngjarjes prandaj i respektoj shumë dhe duhet të shohim edhe bardh dhe të flasim për pika që jemi të caktuar pra ky është mendimi im.

z.Avni Fetahu, theksoi, duke shprehur keqardhjen për rastin në fjalë që ka ndodhur dhe duke uruar që këto raste të mos përsëriten më dhe organet të tjera të merren me familjet e tyre sepse edhe atë janë në një situatë të vështirë që mund të kalojnë në një depresion të thellë. Unë e shoh të rrugës edhe pse sot nuk do duhej të hidheshin si akuza apo diçka të ngjashme është bërë ose jo sepse faktet ekzistojnë, sepse me thënë që janë zero aktivitete dhe zero investime mund të thotë vetëm një njeri që nuk jeton ndoshta në Kosovë dhe Podujevë përndryshe duke nisur nga investimet në siguri ku ka kontratë për pajisje kundër zjarrit ndihmës së parë rrethojat dhe kamerat e sigurisë si dhe sigurimi i transportit krejt këto kontrata që realizohen dhe kontribuojnë në sigurimin e nxënësve, kështu që me thënë zero investime në siguri duhet të ketë argumente për një gjë të tillë, për të thënë zero aktivitete këtu e kemi prezent komandantin dhe e ka një përfaqësues të tyre që për çdo muaj me ato kapacitete që i kanë bëhen aktivitete për vetëdijesimin e nxënësve, shoqërisë kundër dhunës dhe shumë aktivitete që mbahen për çdo muaj dhe për të thënë zero aktivitete kjo nuk tingëllon bukur sepse aktivitetet po realizohen. Lista e nxënësve që janë problematik, këta që janë në teren është fjala për policët me rroba civile e din mirë që atë listë e kanë çdo herë nga drejtorët e shkollave sepse nuk është i interesuar asnjë drejtor të mbaj të fshehur një nxënës problematik ku i nxjerr probleme edhe atij. Kur jemi te Këshilli i shkollës ne për herë të parë mbas 10 viteve e kemi zgjedhur një këshill prezent, është edhe kryetari i këshillit dhe është zgjedh me kryetarët e këshillave që kanë përfaqësuar çdo shkollë. Nga viti 2022 çdo shkollë e dorëzon raportin mujor dhe nuk ka mundësi me dorëzua raportin mujor pa e nënshkruar edhe kryetari i këshillit të prindërve, unë vet kam qenë kryetar i këshillit të prindërve në fshatin tim dhe nuk ka mundësi me kalua muaji pa u takuar me drejtor shkollë dhe pa i diskutuar temat për të cilat na ballafaqohemi çdo ditë, kështu që në këtë aspekt të kisha inkurajua që të flasim të vërteten, se a ka mundësi për përmisim dhe për punë të përbashkëta po sigurisht që ka mirëpo të paraqesim gjendjen që është si krejt zero është e padrejtë për arsyeje se faktet janë ekzistuese dhe janë dëshmitë e komunikimit dhe bashkëpunimit edhe me stacion policor si dhe me këshill të prindërve ku dhe janë faktike.

z.Liman Zeqiri, përshëndetje për të gjithë anëtarët e KKSBB, normal që kjo mbledhje që është thirr sot e ka një shkas, mbledhje urgjente për një dhimbje, për një djalë të ri që jemi të prekur të gjithë edhe unë si anëtarë i këtij këshilli shprehi ngushëllimet e mia më të sinqerta për familje e farë e fis e të gjithë të tjerët. Pasi është shpjeguar në mënyrën më të më mundshme nga Komandanti i Policisë nga Njësitë hetimor dhe nga Kryetari i Komunës dhe të tjerët ne sot nuk duhet të polemizojmë këtë çështje por duhet të japim rekomandime dhe unë kam menduar që të bëhet një zgjim i qytetërimit i qytetarëve që sot ndoshta është dashtë të ketë një protestë që të parandalohen këto, mundësisht me ato kushte që të jenë sa më të vogla dhe mos ti zmadhojmë me media ose fjalime sepse është dhimbje pra në dhimbje nuk bënë të polemizohet prandaj unë mendoj që është një zgjim i joni në dhimbjen e këtij të riut. Unë e kam shqetësimin tim më lart te prokuroria dhe gjykata, e them hapur këtë sepse të bëhen të gjitha ato vepra dhe mos të merren masa më rigorozë, mendoj se duhet të intervenohet nga niveli qendror nga qeveria dhe drejtësia sepse te ne në Kosovë problemi më i madhe është drejtësia, këtë dua të them hapur dhe këtu është problemi te prokurorët gjyqtarët dhe ne kemi raste edhe më të rënda që po ndodhin në tërë Kosovën, por megjithatë për komunën tonë ky rast është shumë i prekshëm dhe i dhimbshëm me përmasa jashtëzakonisht të rënda për neve qytetarëve. Mendoj që duhet të bëhet një fushatë për gjithë qytetarët që të parandalojmë dhe luftojmë këto dukuri dhe ju kisha lutur edhe drejtorit të DKA-së që tash e tutje edhe pse është punuar që të ketë një koordinim sepse vetëm drejtori nuk mund ti menaxhoj vetë ato, pra një koordinim me familjarë, këshillin e prindërve me kujdestarin e klasës drejtori i shkollës dhe të gjithë ne qytetarët të punojmë më shumë me të rinj, sepse e kemi obligim që të punojmë më shumë me ta duke paraparë edhe jetën tonë dinamiken e jetës edhe këto dukuri devijuese të cilat nuk kanë qenë në gjeneratat tona me ato mundësi që i kemi ti eliminojmë sepse e kemi obligim. Unë në bazë të gjitha këtyre informatave që mora e lë fajtor prokurorin.

z.Shemsi Jashari, theksoi, mendoj që rreziku më i madh për siguri është nëse akterët kryesor mendojnë që janë duke kryer punët mirë por fajin e ka dikush tjetër. Nga drejtori i arsimit asnjë shqetësim nuk e dëgjuam, është në rregull me investime të kamerave gjithashtu edhe me aparate të zjarrit, është në rregull me këshilla të prindërve por rezultati nuk është, të gjitha duhen të bëhen dhe kush duhet t'i prij këtij procesi ju pra keni mandat edhe politik edhe juridik që ti prini këtij procesi dhe as prindërit e as nxënësit nuk kanë mandat. Aktivitete vetdijesuese ka mbajtur policia e jo komuna, pra komuna çka ka bërë, jo çka ka bërë Policia, cila është nisma e juaj e fundit që e keni marr për bashkëpunim me Policinë me Bashkësinë Islame, shoqërinë civile një shoqatë vetdijesuese. I ke qendrat rinore jo aktive, këshillin lokal të veprimit jo aktiv i cili është politizuar dhe asnjë aktivitet nuk e ka, po flasim për të rinjtë, pra mekanizmat rinor janë zero asnjë aktivitet, prindërit po nuk amnistohen pra edhe familja e ka një përgjegjësi të madhe por kur mbërrin te policia është vonë, nuk mjafton vetëm me polici, aparatet e zjarrit e kamerat janë mallra që blihen me tender dhe nuk kemi probleme me tenderë ne, por faktori njeri. Nuk është në nivel Komuna e Podujevës dhe nuk je në nivel si drejtor i arsimit, dil vizitoj shkollat sepse lehtë është të flasësh, oratorinë politike e keni të mirë, ne mundemi me dhenë aktivitetet nëse ju si lokomotivë niseni, për ndryshe jemi një vagon sepse nuk kemi mandat për të filluar diçka, e kemi provuar po flas personalisht në këtë këshill dy vjet rresht e kam bërë unë planin dhe asnjë aktivitet nuk është zbatuar. Merri të gjitha procesverbalet, janë fjalimet mija të njëjta, asnjë aktivitet nuk është kryer, pra qysh pret ti për të ndihmua ndokush në shkollë kur ti nuk ia jep mundësinë në asnjë aktivitet. Këshillat lokale që tërthorazi lidhen me çështjen e sigurisë nuk janë të themeluara, KLSP

nuk janë të themeluara, nuk ka interesim por mund të bëhet një zgjidhje. I ke policët që dalin në pension me 65 vjet, e kanë provojë të mjaftueshme dhe asnjë nuk është afruar që ata të jenë pjesë e KLSP-ve. A duhet të bëhet atraktive pjesëmarrja, përgjigja është po, e qysh bëhet ju jeni për të mënduar këtë punë, ju keni mandat politik për me bërë zgjidhje edhe sot diskutuam mjaftueshëm, konstatoam çka kanë konstatuar tërë qytetarët e Podujevës e krejt Kosova por nuk pamë ndonjë propozim se çka të bëhet më tutje. Ne disa ide mund ti japim, ju pra duhet të vazhdoni, të keni propozimin dhe të dilni të thoni se çka po shtoni apo çka po hiqni, nuk dëgjuam nga ju asgjë, edhe dy ditë fillon shkolla dhe në publik nuk e ke asnjë udhëzim dhe asnjë direktivë apo paralajmërim ose tërheqje e vëmendjes për diçka, qysh po pret me u ndryshua gjendja me të njëjtat sjellje dhe asnjë raport nuk është i publikuar prej atyre që i theksove. Kam një pyetje direkt, sa është numri i nxënësve që nuk din shkrim lexim nga fillorja që mbërrijnë në të mesmen, unë jam në dijeni që ke raportin, e ke raportin e njëjtë qe sa kohë copy paste. Ajo çfarë shkruan dhe atë çfarë bënë është e kundërta krejt, dhe mi thënë ndokujt po gënjen ti si Drejtor i Arsimit është dashtë të jesh më shumë kujdes në fjalor por niveli qysh i mësoni fëmijët shihet edhe prej sjelljes suaj. Nëse është dikush duke gënjyer atëherë jeni ju që në fushatë keni premtuar shumë e nuk keni bërë asgjë, në baza vjetore raportoni krejt diçka tjetër ndërsa tjetër gjë bëni. E luani viktimën nëpër takime sikur sot a jeni ju që duhet të merrni drejtimin dhe për të marr veprime, kush po pret që të kryej punët e juaja nga jashtë edhe po harron se në këtë këshill nuk ke rival politik në këtë pjesë por akterë që e përfaqëson dikon. Ato polemika politike ruaji për kuvend sepse rival me neve nuk je, fakti që sot po flasim për një temë urgjencë diskutimi që më herët tha dikush nuk është vendi për të polemizuar unë nuk e di ku është vendi nëse nuk është në kuvend por ne mundemi me ja bërë vetit rrafsh që jemi në rregull edhe me thirr policin që sa here ndodh diçka.

z.Avni Fetahu, në fillim e theksova që nuk jam i interesuar me politizua por ju e krijuat këtë situatë, theksuat që nuk janë mbajtur aktivitete, unë ju tregova që mbahen dhe atë çdo muaj aktivitete sensibilizuese. Ato janë mbajtur në koordinim me Policin e Kosovës për arsye se ne nuk e kemi mandatin që të shkojmë dhe të flasim për narkotik apo diçka tjetër përveç mësimit edukues që e bëjnë mësime ndërmjetit edhe psikologët i kanë aktivitetet ditore. I kemi gjetur shkollat me tre psikolog sot i kemi dhjetë dhe mos harroni që prej angazhimit të psikologëve vendosjes së kamerave edukimit permanent.

z.Shemsi Jashari, theksoi, kush i monitoron kamerat, drejtorët e shkollave që për fat të keq gjysma e tyre nuk kanë njohuri rreth punës me kompjuterë.

z.Avni Fetahu, pse po i nënçmoni kaq shumë drejtorët

z.Shemsi Jashari, jo nuk po i nënçmoj por jam real, kam biseduar me drejtor që thekson që i kanë sjellë kamerat por se nuk dijë të punoj me ato.

z.Avni Fetahu, Cili drejtor shembull.

z.Shemsi Jashari, nuk po dua ta qes nga puna sepse jeni shumë hakmarrës.

z.Avni Fetahu, jeni treguar shumë i ulët në situatë shumë të vështirë por sido që të jetë është karakteri yt dhe të njoh mirë.

Shemsi Jashari, për karaktere flasim sa të doni nëse është dikush që ka luhate në karakter jeni ju sepse si stinët e vitit ndërroni edhe ju. Unë po flas për një problem që i prek fëmijët tonë, nëse ti nuk ki ndjeshmëri për atë punë është shumë problem por jo veç i yti por edhe i joni, por të fshihesh mbas pozitës, mbas fuqisë politike që ke nuk i bënë mirë askujt dhe nëse mendon që e shantazhon dikon si mua me këtë fjalor sikur që i shantazhon ata të tjerët që ja merr dikon në punë është shumë gabim.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, Shemsi je dal nga domeni i diskutimit që e kem të lutem.

z.Qefser Behrami, kërkoj falje kryetar nga të gjithë të pranishmëve që e mora fjalën pa rendë sepse e përfundova diskutimin e më hershëm duke e ditur arsyen se përse jemi mbledhur këtu dhe për çka e kemi fjalën. Më erdh shumë keq dhe dua të ja theksoi dy elemente z. Shemsi Jashari që më duhet patjetër të ja them, e theksoi që nuk ka aktivitete rinore të zhvilluara, i them që ka aktivitete të mëdha që zhvillohen në shkolla një ndër të është kjo, ku këtu me mua është edhe personi nga Amerika që e falënderoj shumë që në bashkëpunim me të i kryejmë shumë aktivitete sportive në shkollë ndërsa elementi i dytë i nderuari Shemsi keni gabuar shumë rëndë kur theksuat që drejtorët nuk e njohin punën me kompjuterë, drejtorët njohin punën me kompjuterë si edhe me kamera sepse nëse nuk e kishin njohur ato gjëra nuk i kishin vendosur aty, mos fol në shumës por fol në njëjës dhe mos e thuaj që nuk dinë drejtorët sepse nuk është e vërtetë.

Shemsi Jashari, theksoi, devotshmëria si militant i një drejtori seriozisht është e dëmshme, nuk thash që janë të gjithë drejtorët e theksova që ka drejtorë, e nëse doni unë mundem të bëj një hulumtim dhe ta bëjë publike por me sjell raportin te ju mbahet në sirtar si shumë sene të tjera që janë dhe nuk është ideja që të cenohet asnjë drejtor, me punuar me kompjuterë kryetar nga ti dhe prej drejtorëve e thërrasim IT sepse e ka punë.

Kryetari përmbylli takimin, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani

Nr. prot.02-060/04-0012990/24
Podujevë, datë: 22.01. 2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

